

VENDIM
Nr. 175, datë 4.11.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MALI”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 1490 kw**

(Ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 31.5.2024; nr. 197, datë 18.9.2024; nr. 238, datë 30.9.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 116/2 prot., datë 22.10.2020, mbi licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 137, datë 21.8.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mali”, me kapacitet të instaluar 1490 kw.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 62/25 prot., datë 25.8.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k.

- Me shkresat nr. 997/1 prot., datë 26.8.2020, dhe 997/4 prot., datë 22.9.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., në përgjigje të ERE-s me shkresën nr. 997/3 prot., datë 10.9.2020, dhe me shkresën nr. 997/4 prot., datë 22.9.2020, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 7.8.2017, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB), me statusin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. ka depozituar në ERE kontratën nr. 99 rep., nr. 75 kol., datë 16.1.2019, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Mali”, me kapacitet prodhues 1.490 mw, në rrjedhën e ujit të pa trajtuar të Ujësjellësit Bovillë, lumi Tërkuzë, Bashkia Tiranë, qarku Tiranë, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., referuar oponencës teknike dërguar në MIE, me shkresën nr. 6815/7 prot., datë 10.10.2018, të kryer për projektin e zbatimit të HEC “Mali”, për të cilin edhe është dhënë nga MEI miratimi përfundimtar nr. 192/2, datë 10.1.2019, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë HEC “Mali”, në rrjedhën e ujit të patrajtuar të tubacioneve të Ujësjellësit Bovillë, Lumi Tërkuzë, Bashkia Tiranë, qarku Tiranë”, rezulton se vlerat e parametrave të HEC “Mali” që pasqyrohen në projektin e zbatimit, janë të njëjtat me ato të pasqyruara në raportin e oponencës teknike dhe, rrjedhimisht, edhe në kontratën e nënshkruar mes MIE-s dhe mbajtësit të miratimit “Tirana Energji” sh.p.k.; raporti i

oponencës teknike konkludon se Projekti i zbatimit për ndërtimin e HEC “Mali”, të shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., plotëson kushtet teknike dhe standardet e projektimit.

- Shoqëria ka paraqitur kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të sipërfaqes së zonës së mbrojtur” me nr. 2/1 prot., datë 8.1.2019, të nënshkruar midis administratës rajonale të zonave të mbrojtura Tiranë, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit.

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. ka përcjellë në ERE marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes me nr. 17056/2 prot., datë 3.1.2019, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OSHEE sh.a., HEC “Mali”, me kapacitet të instaluar 1490 kw do të lidhet nëpërmjet linjës elektrike TM 20 kV të nënstacionit 20/0.4 kV Bovillë, që furnizon fideri 20 kV i nënstacionit 220/110/20/10 kV Tiranë.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. 2369/4, datë 24.9.2019, të miratuar nga KBU Ishëm–Erzen, me vendimin nr. 13, datë 20.9.2019, për shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., me qëllim përdorimin e ujit për prodhim energjie nga HEC “Mali”, me kapacitet 1.49 mw.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, VNM-në paraprake lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 2626 prot., datë 12.9.2018 dhe nr. 679 identifikimi, dhe nr. 42 vendimi, për personin juridik “Tirana Energji” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ndërtimi i HEC “Mali”, me kapacitet 1490 kw”.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”): plotësuar.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”): plotësuar.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”): plotësuar.
 - Dokumentacioni teknik për HEC-in (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”): plotësuar.
 - Leje nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”): plotësuar.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mali”, me kapacitet të instaluar 1490 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Mali”, brenda datës 17.7.2029.*

4. *Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/peçullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*

5. *Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/ mosplotësimit të kushteve të tij.*

6. *Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Furnizuesin e Tregut të Lirë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti